



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2549 / Prot. 10

Patos më 07.08.2026.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 06.08.2026

I mbajtur sot më datë 06.08.2026 në orën 15:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Albiona Lamaj
2. Klaudio Alisinanaj
3. Lori Musaj
4. Artan Velçani
5. Armand Ahmetaj
6. Suela Hoxha
7. Ertilla Myrtaj
8. Elton Seraj
9. Smerald Hazizaj
10. Elmira Rama
11. Renaldo Shpata
12. Eduart Faslliaj
13. Adile Alushaj
14. Shezai Sinanaj
15. Gani Ahmetaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

I nderuar Kryetar i Bashkisë,

Të nderuar qytetarë,

Mbledhja bazohet dhe zhvillohet në bazë të nenit 53 pika 3 germa a ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore si dhe nenit 59 të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak,

Lexojmë rendin e ditës.

Dua t’ju bej me dije qytetarëve që nuk lejohet marrja e fjalës gjatë mbledhjes. Do mundohemi që t’ju japim pak fjalën në fund të mbledhjes.

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Për miratimin e fillimit të procesit të konsultimit me komunitetin për raportin të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale, si dhe për fillimin e procesit të konsultimit me komunitetin lidhur me projektligjin “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.
- 3- Miratimi i kalendarit me komunitetin, grupet e interesit dhe përfaqësuesit e njësive administrative të Bashkisë Patos.
- 4- Ngarkimi i komisionit përkatës të Këshillit Bashkiak për administrimin e mendimeve dhe propozimeve të komunitetit, përgatitjen e raportit përmbledhës të konsultimit, hartimin e mendimit përfundimtar, paraqitjen e saj për miratim në një mbledhje të posaçme të Këshillit Bashkiak.

Para se të kalojmë në votimin e rendit të ditës dua tju pyes nëse keni ndonjë kërkesë për të shtuar apo hequr pika nga rendi i ditës.

Miratohet me 15 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.


SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj



ARTAN VELÇAXII
Smerolo/ Hoxha
Rendebek Sheto



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2540 Prot.
11

Patos më 07.08.2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 06.08.2026 në orën 15:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Për miratimin e fillimit të procesit të konsultimit me komunitetin për raportin të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale, si dhe për fillimin e procesit të konsultimit me komunitetin lidhur me projektligjin “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Armand Ahmetaj- Para se të fillojmë me këtë pikë unë dua të them dy fjalë në cilësinë e kryetarit të këshillit.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

I nderuar Kryetar i Bashkise,

Të nderuar qytetarë,

Ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë mbledhje, e cila është thirrur për të shqyrtuar një çështje me rendësi të veçantë për qytetin dhe bashkinë tonë.

Kemi ndjekur me vëmendje punën e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale, raportin e tij dhe Projektligjin "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i cili parashikon një organizim të ri territorial dhe reduktimin e numrit të bashkive.

Qendrimi im ose vota ime është e qartë dhe e pandryshueshëm është kundër edhe propozimit që ka bërë komisioni por edhe kundër projektligjit që ka nxjerë kuvendi.

E kundërshtoj jo për arsye politike, por sepse nuk kam gjetur ne asnjë pjesë të tij argumente, analiza apo prova që të vërtetojnë se kjo reformë do të sjellë më shumë zhvillim ekonomik, më shumë demokraci apo shërbime publike më cilësore për qytetarët e Bashkisë tonë.

Një reformë territoriale nuk matet me numrin e bashkive që bashkon apo që shuhen. Ajo matet me ndikimin që ka në jetën e përditshme të qytetarëve.

A do të marrë qytetari i Patosit shërbime më të mira pas kësaj reforme?

Deri më sot, raporti dhe projektligji nuk japin një përgjigje bindëse për këtë pyetje.

Më shqetëson gjithashtu mënyra se si është zhvilluar ky proces.

Vetë gjetet e këtij rrëzojnë propozimin e tij!!!

Te gjitha vlerësimet e komisionit, për Bashkinë Patos bazuar në metodologjinë dhe kriteret që ata vetë kanë përcaktuar për tu mbështetur, janë vlerësime pozitive, ndërsa propozimi në kontrast të plotë me vlerësimet.

Te nderuar qytetarë, rrallë ndodh që një analizë të vërtetojë suksesin e një bashkie, ndërsa konkluzioni të rekomandojë shuarjen e saj

Kjo është një ironi që flet vet.

Duket se, sipas kësaj logjike, sa më mire të performojë një bashki, aq më shumë arsye ka për tu shuar.

Ky është një standart krejt i ri në administrimin publik.

Menjëherë pas publikimit të hartës së re administrativo-territoriale, opinioni publik pa një garë politike nga përfaqesues të lartë të komunitetit dhe autorë të propozimit jo për të shpjeguar kriteret e reformës, por për të paragjykuar, për të marrë meritat se kush kishte "shpëtuar" bashkinë që perfaqësonte, për të mos folur këtu për apatinë e treguar nga përfaqesues në kuvendin e Shqipërisë të cilët kanë marrë besimin e qytetarëve të kësaj bashkie në disa legjislatura! Një apati mbresëlënëse të themi.

Një reformë serioze nuk ka nevojë për shpëtimtarë. Ajo duhet të jetë e drejtë që në fillësë, e mbështetur mbi kriterë objektive, analiza profesionale, konsultim real me pushtetin vendor dhe mbi interesin publik.

Meritat maten me zhvillimin që u sjell qytetarëve.

Në këto vite janë organizuar në nivel më të gjerë shërbimet e furnizimit me ujë dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, të gjithë e dini që drejtoria rajonale është në Fier, me premtimin se centralizimi do të sillte më shumë efikasitet. Megjithatë, qytetarët vijnë të përballen me probleme, çka tregon se madhësia e institucionit nuk garanton automatikisht cilësi më të mirë.

Parimi i subsidiaritetit, i sanksionuar në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore, kërkon që vendimet publike të merren sa më pranë qytetarëve. Edhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton autonominë e njësisë të vetëqeverisjes vendore.

Ne nuk kemi detyrimin të mbrojmë kufijtë administrativë për hir të tyre. Detyrimi ynë është të mbrojmë interesin publik dhe të drejtën e qytetarëve për institucione pranë tyre, që ofrojnë shërbime cilesore. Nuk jam kundër reformave.

Unë jam në favor të reformave që përmirësojnë jetën e qytetarëve, por nuk mund të mbashtes një reformë që nuk e provon këtë me fakte, që dobëson përfagësimin vendor dhe largon vendimmarrjen nga komuniteti.

I bëj thirrje Kuvendit të Shqipërisë dhe Komisionit të Posaçëm Parlamentar që ta rishqyrtojnë këtë projektligj përmes një procesi të vërtetë konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore komunitetet e prekura, proces i cili do të realizohet e dokumentohet brenda afateve ligjore të percaktuara.

Sot nuk po mbrojmë vetëm Bashkinë Patos si institucion. Po mbrojmë të drejtën e qytetarëve tanë për një qeverisje vendore të fortë, të afert dhe funksionale.

Ky është detyrimi ynë si përfaqësues të zgjedhur dhe përgjegjësia jonë përballë çdo qytetari të Patosit. Bashkia e Patosit duhet të zgjerohet dhe jo të shuhet.

Ne kemi filluar që sipas ligjit të fillojmë konsultimet publike me komunitetin por më parë duhet vendimmarrja në këshill pra jemi të hapur për diskutime.

Artan Velçani- Realisht me duket se ju harruat se kjo mbledhje është thirrur me urgjencë nga fuqia që i buron pjesëtarëve të keshillit. Dua ta theksoj se këtë për shkak të faktit se vet sensibiliteti i qytetarëve dhe ne dhe ne si përfaqësues të qytetarëve na detyron që të kishim një mbledhje të shpejt. Në fakt e cila përkon dhe me udhëzimin përkatës të komisionit të posaçëm për reformën territoriale, kështu që ne jemi të detyruar ta votojmë pikën 2 për shkak të efektit që jep ligji përkatës për këtë punë por unë doja mëqë e mora fjalën që përveç qëndrimit tuaj qëndrimi në tërësi i të gjithë anëtarëve të keshillit është kundër shkrirjes së bashkisë Patos si njësi funksionale me emrin bashkia Patos. Dhe këtë e gjej të rastit jo vetëm të grupit tonë socialist por mesa shikoj dhe pjesa tjetër është e të njëjtit mendim.

Unë dua të theksoj një përmbledhje personale sepse dhe unë nuk gjej asnjë argument qoftë nga analiza që ka bërë vet komisioni i posaçëm qoftë edhe në momentin kur propozon për bashkinë tonë për shkrirjen dhe bie në anti logjik në raport me ato standarte që raporti përshkruan por po i lë që të gjitha këto të vetmin argument që gjeta atje është 13 minutësh nuk e di ky komisionin me çka e ka matur, duhet të theksoj këtu nga njohurit që kam që patosi edhe përpara viteve të demokracisë ka pasur një situatë të veçantë në raport me qytete të tjera ka qenë ndoshta nga të vetmit që ka pasur

komitet partie dhe komitet ekzekutiv komitet ekzekutiv për të gjithë ata kanë qeverisja vendore dhe nuk e kishte si dhuratë këtë punë po për shkak të sakrificave, për shkak të punës, për shkak të karakterit historik dhe për bashkuar në atë periudhë punën e gjithë këtyre njerëzve në këtë qytet që është krijuar nga baza e naftës dhe mesa di une ne po përpiqeshim të punonim shumë fortë në raport me për ta fuqizuar këtë bashki dhe mendoj që pas disa mandate edhe ky po tregonte që ne po fuqizoheshim për të qenë shërbime sa më afër për të pasur mundësi që qytetarët tanë ta ndjejnë veten si në shtëpinë e tyre për të pasur atë kohezionin që sot kërkohet me urgjencë nga politika ndaj po them atë që kam gjetur domethënë si një gjetje timen, ore duam të qeverisemi vet pikë nuk kemi pse tna qeverisë Fieri. Fieri shumë mirë është vëllai jonë i madh kemi plot marrëdhënie por ne duam të qeverisemi vetë dhe të qeverisemi vet sipas standardeve të vetë raportit ku bëhet fjalë për numrin popullsisë ne duam qeverisemi vetë kush na e krijon pamundësinë për të punë dhe pse sepse në të gjithë këto që thamë ne nuk kemi informacionin e duhur për këtë bile bile ishin të kënaqur sa që na ishte garantuar publikisht që qyteti që bashkia Patosit do të ishte kështu që duam të qeverisemi vete dhe për këtë duam të dëgjohemi nga faktorët duam që të na vijnë të na shpjegojnë mos e kemi gabim t na thonë një dy tre nuk merr vesh nga nga kjo punë dhe unë besoj se ky qëndrimi është qëndrimi gjithë këshilltarëve

Eduart Faslliaj- Para se unë të shpreh qëndrimin tim në lidhje me pikën e rendit të ditës kam një pyetje ky komisioni i reformës ka kontaktuar me pushtetin lokal dhe këtë pyetje kam për kryetarin e bashkisë apo me ju si kryetari këshillit bashkiak për të marrë opinione apo të dhëna të caktuara në lidhje me situatën apo i është referuar thjesht dokumentit shkresor dhe sigurisht që do doja të ishte këtu deputetja e Patosit zonja Dhima që ti drejtoja të njëjtin pyetje për pjesën politike. A është mbajtur një opinion politikisht sepse politikisht unë kam qenë prezente kur u be dëgjesa publike në qark kryetarja e qarkut kjo e tunelit se harrova emrin na falni është shprehur publikisht dhe ka thënë që te gjashta bashkite e qarkut Fier do te ruhen. Në fakt ndodhi e kundërta bashkia me performancën më të mirë sipas indikatorëve të përcaktuara nga komisionin reformës me rreth 16 pikë me diferencë nga bashkitë e tjera është propozuar për të humbur statusin bashki dhe unë nuk e gjej dot rrugën së kujt duhet t'ja drejtoi këtë pyetje. Mendoj që politikisht të duhet të kishte më shumë vend që të merrja një përgjigje për sa kohë që nga momenti që është publikuar drafti nga komisioni reformës deputetja e zonës nuk duket, deputete opozitës e kanë shprehur opinionin e tyre që janë kundër kësaj reformë dhe aq më tepër sigurisht janë kundër dhe humbjes së statusit bashkisë Patosit. Doja të thosha që qytetarët e Patosit duhet ta dinë e para njëherë përshëndes qëndrimin e këshilltarëve mbase nuk munden dot dhe unë i mirëkuptoj që duhet të jenë të drejtpërdrejt në ca gjëra por ndonjëherë kur vjen radha pak më shumë integritet duhet dhe pak më shumë detyrim së shqyrt në numra kur numërojmë Partia Socialiste ka goxha përfaqësues dhe këta përfaqësues ii ka zgjedhë ky komunitet dhe ky komunitet sot është në hall në pa mundësi për të zgjidh problemin e vetë dhe zërin institucionalisht dhe publikisht do duhet ta ngrenë përfaqësuesit e tyre anëtarët e këshillit unë i përshëndes për qëndrimin pak të vonuar për një pjesë të madhe e tyre unë do thoja këtë që qytetarët e Patosit do duhet ta dinë që me humbjen e statusit bashki qyteti Patosit më së pari humbet buxhetin dhe një familje pa buxhet është një familje e shpërndarë që në momenti që nuk ka më para të tjerët do vendosin për fatet tona për përditshmërinë tonë.

Duke humbur buxheti ne do humbasim dhe një pjesë të mirë të shërbimeve, nga praktika që kemi parë me mbylljen e tashmë njësie administrative ish komunave kemi parë që në zonat ku kanë qenë në territoret kanë qenë ish komunat qytetarët kanë humbur shërbimet, një pjesë e mire e shërbimeve janë larguar nga aty dhe për pasojë me humbjen e shërbimeve kanë humbur dhe numrin e popullsisë fshatrat pothuaj ekzistojnë vetëm në hartë kanë ngelur me 20 apo 30% të popullsisë e njëjta gjë do të ndodhi edhe me Patosin ne do të katandisemi si Cakrani duke ikur buxheti do ikin shërbimet duke ikur shërbimet do ikin njerëzit duke ikur njerëzit nuk do të ketë më fëmijë do na mbyllen shkollat, bizneset e vogla të falimentojnë vlera pronës do bjeri në minimum kurkush nuk do shes asnjë banesë asnjë dyqan asnjë rrenj ullinj kërkush nuk do jetë më i interesuar të blej në

Patos edhe këta qytetarë do duhet të dinë prandaj unë ju kërkoj të gjithëve ju anëtarët këshillit ne mesa mundëm bashkë me qytetarët morën një nismë qytetare organizuam një protestë, protesta nuk është qëllim në vetvete por është i mjet i vetmi mjet në gjykimin tim që të ngjallin sensibilitet se çfardo lloj gjëje që të bëjmë ne nëpër shkresa nuk besoj se lart te komisioni reformës e te qeveria do bjeri në vesh të shurdhër unë mendoj që ne ua kemi detyrim qytetarëve t'i prijnë protestave protestat të jenë të forta të jenë radikalet mos të jenë politike po të jenë identitare ua kemi detyrim komunitetit dhe do duhet ta bëjmë sa më shpejt dhe sa më fortë prandaj ju bëj thirrje të gjithëve që të jeni prezent përveçse një kalendar të dëgjesave publike në bashkëpunim me njëri-tjetrin pa e shkruar asgjëkundi kemi dhe një kalendarë protestash mos keni merak se nuk i humb partia nuk ju bie qeveria nga protestat.

Suela Hoxhaj- Të nderuar qytetarë,

I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Sot dua të shpreh qartë qëndrimin tim. Pak ditë më parë e kam bërë publik si qytetare, ndërsa sot po e shpreh para jush si anëtare e Këshillit Bashkiak.

Qëndrimi im kundër heqjes së statusit të Bashkisë Patos është një qëndrim në mbrojtje të komunitetit që perfaqësoj dhe të zërit të shumë qytetarëve që më kanë besuar votën.

Besoj se ky është misioni ynë, të dëgjojmë qytetarët, t'i përfaqësojmë me ndershmëri dhe ta shprehim mendimin tonë me pergjegjësi institucionale.

Patosi është një qytet me vlera dhe njërëz punëtorë që ka dhënë kontribut të rëndësishëm në ekonominë e Shqipërisë.

Nga komunikimet me qytetarët këto kohë, duke u njohur dhe me projekt ligjin "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" nuk mund të mbështes një propozim që parashikon humbjen e statusit të Bashkisë Patos.

Kam disa arsye konkrete.

Së pari, perfaqësimi demokratik.

Vetë procesi parashikon konsultimin me komunitetin. Kjo do të thotë se mendimi i qytetarëve nuk është një formalitet, por një pjesë thelbësore e vendimmarrjes. Nëse shumica e tyre shprehen kundër, ky ze duhet të merret seriozisht në konsiderate.

Se dyti, identiteti i Patosit.

Patosi ka një histori dhe një identitet të veçantë, të lidhur ngushtë me industrinë e naftës, kulturën dhe traditën e tij. Identiteti nuk ruhet vetëm duke e quajtur një territor "qytet", por edhe duke ruajtur institucionet që e përfaqësojnë dhe i japin ze komunitetit.

Se treti, afërsia me qytetarin.

Një nga parimet themelore të vetëqeverisjes vendore është që shërbimet dhe vendimmarrja të jenë sa më pranë qytetarëve.

Së katërti, zhvillimi nuk varet vetëm nga kufijte administrative.

Nuk mjafton të bashkosh territore për të garantuar zhvillim. Zhvillimi matet me cilësinë e shërbimeve, investimet, administrimin e financave, transparencën dhe aftësinë për t'iu përgjigjur nevojave të qytetarëve.

Për të gjitha këto arsye, qëndrimi im është i qartë.

Reformat janë të domosdoshme kur përmirësojnë jetën e qytetarëve.

Prandaj, me respekt për çdo mendim ndryshe, por me bindje të plotë, deklaroj votën time kundër këtij propozimi dhe në mbështetje të ruajtjes së statusit të Bashkisë Patos.

Faleminderit!

Albiona Lamaj - në vazhdimësi dhe të mendimit që shprehu kryetari i grupit të Partisë Socialiste mua më duhet të shprehë mendimin tim që ne do të jemi zëri dhe ne do të jemi bashkë me kryetarin e bashkisë për të mbrojtur që bashkia Patos të qëndrojë ndaj në vazhdimësi edhe të pikës 2 unë përgëzoj shumë këshillin bashkiak për këtë mbledhje të këshillit edhe për masat e mara dhe do të jemi mbrojtja ligjore dhe të ndjekim gjithë etapat rrugën ligjore të mbrojtjes së bashkisë Patosit

ndaj edhe në vazhdimësi të pikës konsultimeve publike do bëhen me qytetarët më lejoni dhe si anëtrare këshilli por dhe si qytetare e bashkisë Patosit të bëjmë thirrje që të gjithë qytetarët janë zëri fuqishëm i këtyre dëgjësave publike dhe zëri i tyre të dëgjohej të materializohet nga ne dhe të shkojë po përsëri fuqishëm tek ata që e kanë bërë këtë reformë territoriale.

Smerald Hazizaj – që në fillim të fjalës dhe më duhet të them se unë jam ulur në këtë karrige këtu sot si përfaqësues i Partisë Socialiste i zgjidhur me votat e Margëllicit, Mustafa Matohiti, Rerësit dhe Oficinës Vjetër e nisa jo pa qëllim këtë fjalë duke thënë që themelet e këtij qytetit e mbajnë rrjedhën rresht direkt nga lagja Mustafa Matohiti si një nga lagjet më të vjetra të qytetit, ishte ajo e lagje që i dha identitet qytetit ishte po ajo oficinë e vjetër që dha bazën e parë të naftës 2027 rrjedh rrjedhimisht në 100 vjetorin e parë të pushtit të territorit bashkisë patos krahas këtyre kohëve që kanë kaluar që ka kaluar nga shpallja e datës që reforma doli dhe u bë publike qytetarët të Margëllicit, Mustafa Matohiti, Rerësi dhe Oficinës Vjetër një zëri bashkarisht të gjithë janë rreth 4000 banorë të cilët e kundërshtojnë fuqishëm që kjo reformë territoriale jo prek vetëm interesat e qytetit të Patosit por e con atë drejt një degradimi të mundshëm.

Unë nuk shoh aq sa kam lexuar dhe mundet të lexojë dhe të kuptojë kjo projekt draft të cilët ata kanë sjell nga parlamenti.

E vetmja menyrë që unë arrij të kuptoj nga kjo gjë është e vetmja pengesë e cilët është afërsia me qytetin e Patosit shtatë kilometra e sjell bashkin Patos në qendër të vëmendjes duke kthyer këtë nesër në një lagje të qytetit të Fierit.

Ne i kemi dhënë shumë se Republikës së Shqipërisë nëntoka e qytetit të Patosit sot është e vetmja burim i cili e bën më gjerë akoma më shumë në ballkan dhe në europë të njihet tashmë si zona e qytetit dhe zona e banorëve Patos Marinza.

Patosit i është ngrënë e drejta për kaq vite me radhë duke mos pasur asnjë lloj përfaqësimi asnjë gjë tjetër mar këtu shkas reformën territoriale të vitit 2015 kur vetë Patosi fshat identik nisi motrën e vet Patosin e Vjetër dhe Patosin e Ri i krijuar rishtazi i shkon bashkisë Fier pra kjo janë disa element Kasnica rëra bituminoze të cilët ish naftëtarë të këtij qytetit dhe sot që janë të shumtë në numër duke njohur disa prej tyre dhe personalisht i është ngrënë e drejta këtij qytetit të madh.

Më zemër të madhe republika e shqipërisë ka fituar shumë, më shumë duhet të fitonte qyteti Patosit jo të vinte në këtë lloj situatë duke e sjellë qytetin e Patosit jo vetëm një instrumente të cilën duhet të ekzistonte në të gjitha dimensionet e veta për të fuqizuar bashkinë e Fierit.

Bashkisë Fierit naftëtarët dhe ish naftëtarët e këtij qyteti kanë dhënë boll.

Fieri ka përfituar sot nga bashkia Patosit as më pak as më shumë thjeshtë se vetëm pak dinjitet i ka dhënë aq intelektual pra erdhi momenti që ne të themi që naftëtarë dhe ish naftëtar janë bërë Fierak Por mos harrojnë që baza kryesore e naftës dhe industrisë është sot Belina e fuqishme e madhe në gjithë territorin e vetë Oficina e Vjetër që të gjithëve naftëtarët e dinë dhe kanë jetuar shumica prej tyre Patosi Vjetër hodhi rrënjët administrata kryesore nga ai italianë deri sot mori shkasë dhe sot ka marrë emrin e madh albpetroli i një superfuqi ekonomike në rangë kombëtar ai shtrihet në territorin e bashkisë Patos është administrimi më i madh hidrokarbureve të cilët janë bërë janë këto disa gjëra që unë them se Patosit i është ngrënë e drejta nuk do të kalojë në penalitetet e cila do të sjellin këtë gjë bashkitë si motrat tona sa mir ka performuar bashki Patos sa keq dhe ku ka çaluar dhe çfarë duhet të përmirësojmë po nuk mundet gjithsesi për vetë historinë e vet që patosi mban.

Unë duhet të sjell në vëmendje këtu si një nga njohësit e mirë që Patosi mban dhe kam kaluar një kohë të gjatë në partinë socialiste me krenarie e thonin gjithë drejtuesit politikë të ardhur këtu se Patosi është një republikë e vogël brenda territorit të Shqipërisë.

Këtu mund të gjejmë po mar këtë ndoshta dhe mund të jem gabim se këtu ka qëndruar një bashki konispoli i përfaqësuar nga çamët shumë bukur na Margëlliçi nga kalaja nga rrëza ku hedh qyteti e ka pjesën e saj Margëlliçi ka pjesë e Çamërisë Lagje e Re që cilën sot ka marrë një nga zhvillimet janë banorët të cilët atje kanë qenë ja pra dhe Patosi ka brenda ekzistencës vetë mos harrojmë këtu që brenda territorit bashkisë Patos në lagjen lagjen Dukas një Dukas dy janë papërsëri Dukasi çobanë që ne me krenari i themi ata kanë pjesën e komunitetit ja të tyre pra të nderuar kolegë unë

sot po shpreh vetëm një opinion vendimin dhe me votën do ta shprehet ditën kur unë të dalë si anëtar i këshillit bashkiak duke dëgjuar çdo qytetarë
ju faleminderit dhe shpresoj dhe uroj që zëri jonë të dëgjohet dhe bashkia Patosit jo të jo të ngeli bashki po thjesht ti rikthehet identiteti i munguar.

Klaudio Alisinanaj - shumë shkurt dhe unë fakt në emër të banorëve të lagjes së Re dhe në emrin tim personal duhet të shpreh se dhe ne nuk jemi dakord me raportin e ardhur nga komisioni për reformën territoriale jo për të gjithë raportin po për pjesën që preket bashkia Patos sigurisht kanë sjellë argumentet e tyre sipas dhe letrës së ardhur nga kuvendi ku pasqyron qartë ato hapat që ne do të ndjekim se prandaj jemi mbledh sot të zhvillojmë ato konsultimet publike le të gërshetojmë idetë me njëri-tjetrin si anëtar këshilli të ngremë ndoshta një grup punë ose një komision me njëri-tjetrin që të bëjmë një mbrojtje unanimiti le ta quajmë ose një argumentim unanimiti si këshillë dhe tja paraqesim komisionit sipas porosisë së kryeministrit kështu që ftoj këshillin që ta ngremë një grup pune dhe të dalim me një raport përfundimtar.

Shezai Sinanaj – unë si anëtar i këshillit bashkiak dhe përfaqësues i opozitës në qoftë se do jetë një moment dhe vetëm një që unë bashkoj votat me kolegët socialistët është ky moment sot dhe mund të jetë dhe i fundit por sot jam bashkë me ju që ne ti themi jo dhe jo të fortë komisionit të posaçëm të reformës territoriale dhe shikoj të pavendë nuk dua të zgjatëm vota ime kundër shkrirjes së bashkisë Patos.

Renaldo Shpata- Bie dakord me çka u tha më sipër nga kolegët, ky është dhe mendimi i gjithë qytetarëve që Patosi duhet të vazhdojë së ekzistuari, arsyet janë të shumta pse duhet të jete dhe ne do të bëjmë të pamundurën duke ndjekur gjithë hapat ligjore për ta kundërshtuar këtë projekt-draft.

Ertilla Myrtaj- Dhe unë si antare e lagjes më të madhe të qytetit Patosit jam kundra shkrirjes së bashkisë Patos por përkundrazi nga bashkia Patos që ka performuar në mënyrë të shkëlqyer duhet të marrin shembull bashkitë e tjera që nuk janë në shkallën e bashkisë Patos.

Lori Musaj - përshëndetje të gjithëve nuk dua të zgjatëm se pak a shumë të gjitha pikat diskutuan normalisht është mbështetja ime në këtë rrugëtim që kemi nisur të bëj më të mirën për qytetarët e Patosit dhe për të gjithë ne.

Gani Ahmetaj – dhe vota ime është kundër shkrirjes së bashkisë.

Elmira Rama - përshëndetje duke qenë se unë jam përfaqësuese njësisë administrative Zharrës realisht e kam të vështirë që të shprehem pa mendimin e komunitetit sepse ashtu sikurse është edhe rendi ditës unë preferoj që të zhvillohen dëgjuesat publike të merret mendimi i komunitetit dhe pastaj të japim mendimin përfundimtar ndryshe nga gjithë kolegët e mi kanë këtu edhe qytetarë të qytetit Patosit unë nuk shikoj as kolegët e mi anëtarë të këshillit kështu që do të preferoja pas dëgjësave publike edhe në zbatim të nenit 90 ligjit të vetëqeverisjes edhe të pikës dytë të nenit 108 të Kushtetutës.

Kryetari i Bashkisë- mbase kjo mund të jetë një nga mbledhjet më të rëndësishme që këshilli ka bërë nga 2023 të paktën që jam unë kryetar bashkie dhe sot jemi para faktit që na ka ardhur një propozim nga ana e komisionit të posaçëm parlamentar për shkrirjen e bashkisë Patosit dhe bashkimin e saj me bashkinë e Fierit, ky është akoma në kuadrin e propozimit ndryshe nga ju unë e shikoj disi ndryshe këtë gjë unë e shikoj më shumë si një përgjigje teknike dhe duke e studiuar teknikisht të gjithë dokumentacionin e ardhur nga ana e komisionit të posaçëm pjesa që argumentohet që bashkia Patos duhet shkrihet më bashkinë e Fierit janë katër faqe në total që

argumentohet posaçërisht për bashkimin e bashkisë Patosi me bashkinë e Fierit ndërkohë që projektvendimi i këshillit bashkisë le të thëmi një projektvendim për ndihmën ekonomike që është cdo muaj është më shumë se katër faqe flas gjithmonë teknikisht nuk do ti hyj fare pjesës pasi nuk besoj se ka ndonjë banorë që ka jetuar në Patos që të jetë pro kësaj gjëje.

Që një reformë administrative të bëhet duhet të plotësohen disa kushte pse është e nevojshme bashkimi i Patosit me Fierin a kanë ndonjë alternativë tjetër për këtë gjë dhe përfitimi të jetë më i madh sesa dëmi që mund të shkaktohet nga shkrirja e kësaj e bashkie më një bashki më të madhe. Relacioni nuk bën asnjërin prej këtyre ai nuk analizon gjithashtu as rritjen e transfertës së pakushtëzuar as bashkëpunimi ndërbashkiak që mund të shtohet as delegimin e funksioneve edhe as reformimin e financave të Patosit pa e shkrirë bashkinë.

Pra mungon një analizë e mirfilltë nga ana e komisionit gjithashtu që një bashki të shkrihet normalisht që ajo bashki duhet të jetë jo funksionale vet relacioni përdorur tre tregues, indeksi funksionalitetit, indeksi performancës ekonomike, indeksi menaxhimit urban ku tek të treja Patosi është më mirë së Fieri edhe te indeksi funksionalitetit Patosi është i 10 në Shqipëri diku te 16 pikë më shumë sesa Fieri, indeksi performancë ekonomike borxhi bashkisë Patos është 0 performanca ekonomike është më e lartë sesa e bashkisë së Fierit.

Indeksi menaxhimit urban përsëri është më i lartë i bashkisë të Patosit sesa i bashkisë Fier por komisioni komisioni e ka vlerësuar indeksin e menxhimit urban të Patosi si mjaftueshëm ndërsa të Fierit si të fortë kjo është për shkak se indeksi i menaxhimit urbane është raport i qytetarëve që banojnë në qytet kundrejt numrit përgjithshëm të banorëve dhe Fieri duke qenë se është një bashki me numër të madh popullsie pjesën e banorëve në tërësi që banojnë në qytete e ka shumë herë më madhë se Patosi pasi është qytet më i madh.

Në të drejtën administrative nuk mund të thuash që thjesht një bashki është më mirë edhe kjo tjetra ta mbyllim apo kjo bashki nuk mund të funksionoi kjo gjë duhet argumentuar e gjitha me letra edhe analiza financiare nuk është e plotë relacioni flet për kursime por nuk tregon sa milion lekë kursehen nga kjo reformë, sa kushton tranzicioni, sa kushton mbyllja e bashkisë në thonjëza pasi institucioni do të qëndrojë por me numër më të kufizuar punonjësish, sa kushton transferimi personelit, dhe sa kushtojnë dhe gjithë hapat e tjera që duhen gjatë këtij procesit.

Pa këto shifra ne nuk mund të themi se bashkimi është ekonomisht më i favorshëm përfaqësimi demokratik dobësohet.

Vet relacion përmend që Patosi do të përfaqësojë rreth 15.2% të popullsisë përgjithshme të bashkisë së re kjo do të thotë më pak këshilltarë më pak ndikim në buxhet më pak ndikim në investime dhe më pak zë në vendimmarrje në një botë demokratike normalisht shumica ka të drejtë në votim dhe në qoftëse Fieri ka x këshilltar Patosi ka shumë herë më pak sado të ngrihet zëri këshilltarëve në fund vendos shumica se ku do të lëvizin ato investime dhe ku do shkojnë to fonde.

Normalisht është edhe identiteti qytetit por edhe për këtë relacioni thotë vetëm që identiteti do të ruhet por nuk shpjegohen sesi si do ruhet historia, si do ruhet administrimit, si ruhen institucionet, dhe shumë e shumë gjëra të tjera por kjo për mendimin tim nuk është diçka fortë që ne mund të mbrojmë bashkinë e Patosit nuk mbrohet më patriotizëm por mbrohet me letra. Ne do të flasim me letra.

Nafta përdoret si argument për bashkim relacioni thotë se zona naftëmbajtëse duhet menaxhohet bashkë Patosi është qyteti simbol i industrisë naftës, nuk ka qytet tjetër mbase Kuçova mund ti afrohet ose janë aty aty po jo si Patosi dhe në qoftë se do trajtohet në mënyrë të tillë nuk është vetëm Patosi që ka industri naftë është edhe Roskoveci që kanë industri naftë është edhe Mallakastra që ka industri naftë kështu që nëqoftëse do të ikim më këtë argumentet do ishin bashkuar të gjitha bashkë të bëheshin një bashki e madhe me këtë argument në qoftëse do niseshim

me argumentin e naftës që të menaxhojë pjesa e ndotjes së mjedisit, për mua distanca nuk është argument pasi ka dhe bashki të tjera në vend edhe jashtë Shqipërisë që janë kilometra kilometra larg, ka edhe të tjera që janë akoma më afër edhe janë përsëri bashki më vete janë ngjitur siç është edhe kjo nuk është argument sepse një bashki bashkia e Selenicës për shembull është diku te 40 kilometra larg dhe ajo përsëri bashkohet me Vlorën kur distanca është 40 km këtu është 7 km atje nuk përdoret si argument këtu përdoret si argument pra linja e një reforme duhet të jetë e barabartë për të gjithë normalisht gjithashtu nuk provohet dhe përmirësimi i shërbimeve relacioni premtion më shumë investime shërbime më të mira administratë me efikasë të kjo pjesë e administratës unë do ndalem pak më mbrapa. Për sa i përket shërbimeve besoj se shumë prej jush udhëtojnë në Fier nuk e mbaj mend kur ka qenë sa muaj ka domethënë po në Mbyet janë dy kosha në mes të rrugës që normalisht varen nga ndërmarrja e pastrim gjelbërimit të Fierit ata vazhdojnë janë atje në mes rrugës burim aksidenti.

Çfarë të mirë do i sjelli kjo ndërmarrje shërbimit Fierit, Patosit kur nuk rregullon koshat që i ka brenda bashkisë saj sot praktikisht nga çfarë shohim. Normalisht proces shumë rëndësishëm janë dhe konsultimet publike që ne do ti vazhdojmë gjatë gjithë muajit Shtator, të dëgjoj dhe çfarë thone qytetarët.

Përsa i përket investimeve une do ti kërkoj paraprakisht ndjesë të të gjithë qytetarëve të bashkive të tjera të qarkut por janë disa gjëra që unë duhet ti them.

Përsa i përket investimeve nga 2024 deri në 2026 Patosi renditet i dytë në qark për vlerë investimesh dhe i treti në Shqipëri jo për vlerë investimesh në shqipëri por për pjesën për përqindjen e investimeve që janë në përqindje të pjesës totale të buxhetit e kthyer në shifra për vitin 2024, 2025, 2026 e papërfunduar Patosi është i pari në 2025 rang qarku për investime vlerë total investimesh dhe Fieri është në 2025 është i 4 në rang qarku në qoftëse do ti mbledhim total si vlerë vlera është në lekë pa tvsh të rinj investime e bashkisë Patos për vitet 2024 2025 2026 në vlerë lëku janë 935 milion 219 mijë 890 lekë, për bashkinë Fier janë 596 milion 523 mijë 379 leke gati sa gjysma. Për bashkinë Lushnjë që është dhe e para është 1 miliard e 45 milion 718 mijë e 544 për bashkinë Roskovec 698 milion 510 mijë 283 lekë, për bashkinë Mallakastër 694 milion 124 mijë 123 lekë, për bashkinë Divjakë 200 milion 396 mijë 955 lekë pra nqs do shohim nga ana e investimeve bashkia Patos renditet e dyta në qark nga popullsia është e katërta.

Pra e para është Lushnja i dyti Patosi i treti Riskoveci i katërti Mallakastra i pesti Fieri dhe e gjashta Divjaka dhe unë besoj që ne fund të vitit në mund të shkojmë dhe në vend të parë duke parë investimet që janë planifikuar për këtë vit po ende nuk janë bërë . Gjithashtu Patosi renditet i pari në qark për vlerën e investimeve infrastrukturë të bëra nga punonjësit e bashkisë, është i pari dhe besoj se duhet të jenë dhe të parët në Shqipëri. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në Patos rrugët nuk diskutohen, kanalizime, trotuare, ura, mure dhe janë për tu falenderuar ata punonjës edhe për pjesën e pastrim gjelbërimit mund të jetë bashkia më e pastër në qark normalisht që ka probleme se mund të prishet ndonjë mjet. Shpenzimet operative janë shpenzimet në mënyrë figurative që i shërbejnë bashkisë për të mbajtur veten po mar vetem një vit 2025 që janë rreth 42 milion e 944 mijë 868 shpenzime operative të bashkisë Patos për vitin 2025 dhe shpenzimet operative të bashkisë Fier janë 333 milion 789 mijë e 885 lekë gati 8 herë më të larta. Çfarë të mirë na sjell ne bashkia Fier kur ne investime kemi më shume se bashkia Fier. Llogjika e shifrave është e kundërta që ne i sjellim të mira bashkisë Fier edhe në futboll ne këtë vit ne e mundëm Apolloninë me 11 me 0.

Ne kemi 4 parqe për fëmijë ndërsa për Fierin nuk di të këtë.

Të gjitha këto në do ti shprehim në qendrimin tonë do ti dërgojmë Komisionit të Posaçëm Parlamentar që nuk do të jetë katër faqe.

Artan Velçani - besoj unë që edhe me shpjegimet që dha kryetari bashkisë po edhe për shkak se këtu u konfirmua një mazhorancë e caktuar e cila nuk ka dilemë në raport me detyrime që përcakton ligji të kësaj mbledhje pra pak a shumë shqyrtimin e materialit të komisionit të posaçëm për reformën territoriale, kryetari i bashkisë me shembuj shumë domethënës vlerësoi faktin që edhe ne e thamë që tek e fundit fare cilat janë përfitime të qytetarëve të bashkisë Patos pra ishte dhe ky një qëndrim që është shprehur ndoshta dhe publikisht për shkak të faktit që unë thashë po besoj ishte gjetje në të gjithë anëtarët e këshillit bashkisë Patos si përfaqësues të komuniteteve të tyre që është një kërkesë organike duam të qeverisemi vetë për shkak se nuk po na afrohen apo të na jetë e garantuar që shërbimet do të jenë më të mira më cilësore dhe tek e fundit fare lidhur me disa ide që kanë dalë nëpër rrjete sociale për shkak të kërkesave të BE nuk i gjetëm fare në material.

Kështu që unë mendoj që mbi këtë konsideratë në të vazhdojmë të miratojmë këtë pikë duke menduar të ezauroar pikë numër 2 dhe të kalojmë menjëherë me pikën 3 të miratohet kalendarit dhe ne jemi gatshëm që të shfrytëzojmë kohën që na është lënë në dispozicion.

Armand Ahmetaj – doja tju sqaroja në lidhje me bazën ligjore të pikës 2.

Baza ligjore është Kushtetuta neni 108 i saj pika 2, ligji 139/2015 Për veteqeverisjen vendore veçanërisht neni 86, 93 si dhe neni 89 pra do tjuja dërgojmë bazën ligjore në email ta keni dhe pak më të zgjeruar sepse është udhëzim i ardhur nga Kuvendi.

Pa humbur kohë dua kalojmë votimin e pikës dy

Kush është dakord?

Miratohet 15 pro asnje kundër asnjë abstenim


SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj



Artan Velçani
Smiraj Hoxha
Rendona Shyqja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2540 Prot.

112

Patos më, 07 08.2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 06.08.2026 në orën 15:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Miratimi i kalendarit me komunitetin, grupet e interesit dhe përfaqësuesit e njësive administrative të Bashkisë Patos.

Armand Ahmetaj duhet theksoi paraprakisht që gjatë kësaj kohë ne kemi kryer bisedime apo kontakte me administratën apo kryetarin e bashkisë dhe kemi dakordësuar që kalendar i dëgjesave me komunitetin të jetë i njëjtë si i bashkisë edhe këshilli pra të jenë të njëjtat data vende dhe orarare pra do të zhvillohen bashkarisht.

Eduart Faslliaj - kryetar unë mendoj për këtë pikën mospakti duhet ta kishim gati kalendarin.

Armand Ahmetaj- besoj është gati kryetari pak a shumë tha që do ta zhvillojmë gjatë muajit shtator tani po shikojmë që mos kemi përplasje me kalendarin që kemi miratuar në nëntor dhe do të saktësojë dhe menjëherë brenda ditës sotme kalendarin do të jetë gati.

Eduart Faslliaj- sepse kemi dy pika në rendin e ditës pikën 3 dhe 4 që kërkojnë të miratojnë dhe skemi asnjë gjë konkrete nuk kemi një kalendarë nuk kemi propozuar një komision.

Armand Ahmetaj- komisionet i propozoi unë ma cakton si të drejtë rregullorja dhe unë kam menduar që meqënëse kjo është çështje shumë e rëndësishme të ngarkohen të gjithë komisionet veç komisionit të mandateve dhe në fund fare të gjithë komisionet marrin pjesë në përpilimin e raportit i cili do të dërgohet kuvendit si dhe do të paraqitet paraprakisht në këshillin bashkiak për votim pastaj i dërgohet institucioneve përkatëse.

Kush është dakord me pikën tre, me miratimin e kalendarit të përbashkët se bashku me bashkinë. 15 pro asnjë kundër miratohet.

Është larguar këshilltarja Adile Alushaj dhe ka ardhur këshilltari Zejni Musaj.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2540 Prot.

13

Patos më 07 08.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 06.08.2026 në orën 15:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Ngarkimi i komisionit përkatës të Këshillit Bashkiak për administrimin e mendimeve dhe propozimeve të komunitetit, përgatitjen e raportit përmbledhës të konsultimit, hartimin e mendimit përfundimtar, paraqitjen e tij për miratim në një mbledhje të posaçme të Këshillit Bashkiak.

Armand Ahmetaj komisionet që do të angazhohen në këtë proces do të jenë
Komisioni Integritetit Europian i pari
Komisioni Shërbimeve Publike i Zhvillimit Urban Ndërtime dhe Pronat.
Komisioni i Ligjeve Marrëdhëniet me Komunitetin dhe Jashtë.
Komisioni për Barazinë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale.
Komisioni i Ekonomisë Financës dhe Ndihmave Ekonomike.
Komisioni i Arsimit Shëndetësisë Kulturës Rinisë dhe Sporteve.
Komisioni i Bujqësisë Veterinarisë dhe Mbrojtjes.

Eduart Faslliaj- më thoni që do të angazhohen të gjithë komisionet që kemi paracaktuar në çformë do të administrojnë materialin nga dëgjesat publike ne do mbajmë shënime mbi qëndrimet që të mbajnë, opinionet që të ketë komuniteti nuk do duhet të kemi në një komision posaçëm që të administroi këtë gjënë? dhe me përfaqësim të gjitha forcave politike të dalim me një vendim të caktuar dhe të miratojmë në këshill.

Në ç formë do ta bëjmë me të gjithë komisionet nuk gjej formë konkrete.

Armand Ahmetaj- secili komision do bëjnë pjesën e vetë atë që i takon, tek materiali do marrin pjesë të gjithë komisionit pra nuk do jetë siç e tha dhe kryetari material me katër fletë sepse ne kemi parashikuar konsultime me grupe interesi që mund të jenë dhe ekspert..

Albiona Lamaj - ne mund ta miratojmë në parim një komision në një numër të caktuar anëtarësh që mund të jenë të pozitës dhe të opozitës dhe pastaj e vendosim edhe për rregulloren se si do funksionoi dhe si do jetë komisioni sot e miratojmë në parim edhe pastaj shikojmë thotë komision pasi ne bëjmë dëgjesat publike gjithë këto komisione do jenë të angazhuara për të dëgjesat publike thotë për materialin pastaj do të jetë.

Armand Ahmetaj materiali do shihet nga gjithë komisionet.

Albiona Lamaj - po pra le të jetë një komision që ti bashkangjisim mendimin e të gjitha komisioneve.

Armand Ahmetaj- nuk është e thënë që komisionet të jenë prezente në terren apo në të gjitha konsultimet sepse këto e dimë që jemi në pamundësi në këtë pikë por i gjithë materiali i grumbulluar do të kalojë në të gjitha komisionet.

Artan Velcani- këtu nuk bëhet fjalë për një komision për të ndjekur dëgjuesat sepse të gjithë pranuan paraprakisht që do të bëjmë bashkë për juve dhe për qytetarët të jemi detyruar sipas udhëzimit që ka dhënë komisionin do duhet ndërtuar dy raporte në efekt të kundërshtisë apo të pranisë së propozimit që do të thotë që kryetari bashkisë ka detyrë që të ndërtojë nga pikpamja administrimit raportin e tij mbi propozimin dhe ne si anëtar këshilli raportin tonë që do të thotë që mos të ngatërrohem nëpër dëgjues publikë unë do kërkoja që të gjithë anëtarët e këshillit të jenë edhe të artikulohen aty qëndrimin së bashku me qytetarët, ajo që duhet të kuptojmë është fakti që ky material duhet të kalojnë të gjitha komisionet sepse i prek të gjitha problematikat

Eduart Faslliaj- ne do të organizojmë dëgjues publikë dëgjuesat publikë organizohen në dy forma i organizon ekzekutivi dhe këshilli dakortuam që do t'i organizojmë bashkë a nuk do të të ngremë në një që të administrohet gjithë opinionet nga dëgjuesat publikë ca materiale të shkruara të dalim më një material konkret që të kalojnë nga komisionet pastaj

A duhet të kemi ne siç kanë ndodh gjithmonë. Unë do doja të ngrinim një komision se do kemi dhe problematika të tjera.

Kryetari Bashkisë- Beni një komision me 21 anetar se të gjithë do duan të marrin pjesë

Eduart Faslliaj- Kryetar na lë të bëjmë punën punën tonë se nuk e ruajte dot bashkinë

Kryetari Bashkisë-Gjeja më e mirë që mund të bëj një bashki është të funksionoj dhe shifrat tregojnë se bashkia e Patosit funksionon.

Armand Ahmetaj- Ne do bëjmë pjesën tonë.

Eduart Faslliaj- Asnjë nuk e ka marrë në konsideratë as punën e mirë që ka bërë ekzekutivi, as këshilli i bashkisë as mbështjetjen që i ka dhënë qytetarët e Patosit, kurrkush sdo tja di. Kryetarja e qarkut doli nga dëgjues publikë dhe deklaroi publikisht se i kemi ruajtur të gjashta bashkitë e qarkut dhe ndërkohë që bashkia me performancën më të mirë nga indikatorët që I ka nxjerrë vet komisioni reformës rezultojmë ne dhe ne shkrihem.

Armand Ahmetaj –Secili komision ka orientimin e vet. Në komisione ka specialitete të ndryshme. i gjithë materiali që do dali nga konsultimet do kaloj për vlerësim në cdo komision.

Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e katërt.

Miratohet me 14 vota pro, abstenim ska, kundër 1.

SEKRETARE



Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



Artan Velcani



Renelba Shqaba